

TITULLI I KURSIT: Mësimdhënëia e avancuar

Niveli dhe lloji i kursit: Master – i detyrueshëm
Programi: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
Viti i studimeve: I (2017 – 2018)
Numri i orëve në javë: 3 orë
Kodi – shifra e lëndës: Edu 109 D
Vlera në kredi ECTS: 7
Koha – lokacioni: Semestri dimëror 2017, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë
Mësimdhënësi: Prof. asco. dr. Naser Pajaziti
E-mail: E-mail:
naser.pajaziti@uni-pr.edu
naser_pajaziti@yahoo.com (Tel. 044/149 265)

PËRSHKRIMI I KURSIT

Mësimdhënëia e avancuar si lëndë në nivelin master synon të aftësojë profesionalisht studentët e profilin të mësimdhënësit për shkollën e mesme të ulët, duke ngritur nivelin e përgatitjes profesionale në mësimdhënie.

Përmes këtij kursi synohet t'u japet studentëve-mësimdhënësi vizioni i mundësive për arritjen e mësimdhënies bashkëkohore përmes zbatimit të parimeve, kriterëve, metodave, teknikave, formave dhe strategjive më të përparura sot e që lidhen me mësimdhënien, të nxënimit dhe vlerësimit e nxënësve.

Njëkohësisht, përmes kursit të **Mësimdhënëia e avancuar**, synohet t'u qartësohen studentëve - mësimdhënësi disa specifika të gjuhës shqipe si lëndë mësimi dhe lëndë mësimore në arsimin e detyruar nëntëvjeçar.

. Duke mbajtur parasysh rolin e rëndësishëm që ka ky kurs për mësimin e gjuhës shqipe paraparë këto qëllime :

- roli më aktiv komunikues i gjuhës;
- roli mësimor i saj;
- roli lidhës ndër-lëndor;
- roli edukues dhe arsimor;
- të krijuarit e pavarësisë vetjake (individuale);
- të përvetësuarit e shkathtësive (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit);
- të motivuarit për të nxënë;
- të përvetësuarit e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit letrar;
- të përvetësuarit e gjuhës letrare si në të folur ashtu edhe në të shkruar

OBJEKTIVAT E KURSIT

Mësimdhënëia e avancuar ka si objektiva:

- Të aftësojë** studentët/mësimdhënës në profesionin e tyre.
- Të argumentojë** ndryshimet mes shumë drejtimeve të të mësimdhënies duke nxjerrë në pah epërsitë e njerës karshi tjetrës.
- Të aftësojë** mësimdhënësit edhe si zotërues të teknikave dhe strategjive të bashkëkohore në mësimdhënie.
- Të thellojë** studentët /mësimdhënësit në disa procese mendore që lidhen me gjuhën dhe me nxitjen për përvetësimin e saj më të mirë në procesin e të nxënimit .
- Të thellojë** njohuritë rreth procesit të të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit dhe disa dukurive individuale që ka në të bejnë me përvetësimin e gjuhës stadarde shqipe .
- Të zhvillojë** disa aftësi profesionale që kanë lidhje me komunikimin si proces i vazhdueshëm dhe raportet midis të folurit , leximit dhe shkrimit
- Të orientojë** studentë /mësimdhënës drejt një mësimdhënie të mbështetur në kritere, parime, metoda dhe strategji bashkëkohore.
- Të përgatisë** studentët /mësimdhënës për të modeluar mësimdhënien mbështetur në teknikat e strategjitë të reja.
- Të rekomandojë** për studentët /mësimdhënës forma pune të larmishme që mundësojnë sukses në mësimdhënie dhe në nxënie

REZULTATET E PRITURA NGA KURSI

<p>Në përfundim të kursit “ Mësimdhënënia e avancuar” studentët-mësimdhënës duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohin teoritë dhe përvojat e traditës si dhe mësimdhënien bashkëkohore të gjuhës; - të krahasojnë teoritë e të mësuarit duke argumentuar përparësitë e njerës kundrejt tjetrës; - të shprehin bindjet e tyre lidhur me teorinë më të përshtatshme për mësimdhënien dhe të nxënit në shkollën tonë ; - të dallojë metoda, forma, strategji dhe teknika që nxisin një mësimdhënie dhe nxënie të suksesshme, ndërvepruese; - të hartojnë modele mësimdhënie, ku të përdorin metodat që nxisin mendimin kritik, të nxënit në bashkëveprim, duke provuar se dinë t'i përdorin; - gjatë seminareve të vëzhgojnë, të diskutojnë, të argumentojnë të marrin pjesë aktive jo vetëm në detyrimet individuale. 			
JAVA	ORËT	TEMAT E PARAPARA SIPAS JAVËVE QË DO TË TRAJTOHEN NË ORËT MËSIMORE	DETYRAT (APO AKTIVITETET E MËSIMDHËNËS TË CILAT DO TË VLERËSOHEN NË ORËT MËSIMORE)
I	2 orë 1 orë	<p>Mësimdhënënia e avancuar</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qëllimet dhe objektivat mësimdhënënie. - Lidhja e mësimdhënënis së gjuhës me shkencat e tjera. <p>Ushtrime: <i>Kultura e të dëgjuarit, të folurit dhe e të shkruarit</i></p>	
II	2 orë 1 orë	<ul style="list-style-type: none"> - Plani dhe programi mësimor i gjuhës shqipe në shkollën e mesme të ulët (qëllimet dhe objektivat) - Planifikimi vjetor i lëndës dhe përbërësit e planit ditor. - Tekstet alternative dhe përzgjedhja e tyre. <p>Ushtrime: <i>Planifikimi vjetor (linjat dhe nënlinjat), mujor dhe përgatitja e planit ditor për njësinë mësimore (punë në grupe)</i></p>	<p>Jepen punime seminari.</p> <p>Temat e seminarit i cakton mësimdhënësi në pajtim me vijuesit. Secili e punon seminarin me shkrim në shtëpi. Seminari i shkruar dhe i mbrojtur me gojë (i analizuar) vlerësohet para krejt klasës. Punimi i pranuar shënohet në fund të indeksit</p> <p>Vlerësohet me 20%</p>

III	2 orë	- Kriteret e modernizimit shkencor e didaktikë të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë. - Metodrat (bashkëkohore) e mësimdhënies në gjuhën amtare: epërsitë, kufizimet - Metodrat me në qendër mësuesin	Të hartuarit e esesë Vlerësohet me 10%
	1 orë	- Metodrat me në qendër nxënësin - Metodrat e hulumtimit	
IV	2 orë	- Teknikat e mësimdhënies dhe zbatimi i tyre në lëndën e gjuhës shqipe	
	1 orë	Ushtrime: Punë në grupe përkitazi me përdorimin e teknikave bashk. në mësimdhënien e gj. shqipe (sipas etapave të orës mësimore)	
V	2 orë	- Teknika dhe teknologjia mësimore - Teknikat (mjetet) mësimore të mësimit të gjuhës shqipe (tabela, grafoskopi, magnetofoni, diapozitivat, diafilmi, filmi dhe televizioni, episkopi, epidiaskopi, diaprojektori, kompjuteri – klasa kompjuterike, responderi, interneti)	Testi i parë me shkrim Vlerësohet me 30%
	1 orë	Seminari: Modele të njësive mësimore (me përdorim të teknikave – mjeteve mësimore përkatëse në mësimet e fonetikës dhe fonologjisë)	
VI	2 orë	Mësimi i morfologjisë	
	1 orë	Seminar: <i>Modele të mësimdhënies</i> <i>Si të vlerësohen gabimet gjuhësore të nxënësve</i>	
VII	2 orë	Mësimi i fjalëformimit	
	1 orë	Seminar: <i>Modele të mësimdhënies</i>	
VIII	2 orë	Mësimi i sintaksës	
	1 orë	Seminar: <i>Modele të mësimdhënies</i> <i>Si të vlerësohen gabimet sintaksore të nxënësve (me theks të veçantë në radhitjen – të topikës së fjalëve në fjali)</i>	

IX	2 orë	Drejtskrimi dhe drejtshqiptimi	
	1 orë	Seminar: <i>Modele të mësimdhënies</i> <i>Përdorimi i shenjave të pikësimit</i>	
X	2 orë	Mësimi i kulturës së shkrimit	
	1 orë	Seminar: <i>Modele të mësimdhënies</i>	
XI	2 orë	Mësimi i leksikologjisë	
	1 orë	Seminar: <i>Modele të mësimdhënies</i> (homonimet, antonimet dhe sinonimet)	
XII	2 orë	Mësimi: Dialektet dhe dialektologjia	Vlerësimi i pjesëmarrjes dhe i angazhimit në orët mësimore vijon deri në javën e dymbëdhjetë. Vlerësohet me 10%
	1 orë	Seminar: <i>Modele të mësimdhënies</i>	
XIII	3 orë	MATJA, KONTROLLI DHE VLERËSIMI I NJOHURIVE. -Vështrim i përgjithshëm për matjen, kontrollin dhe vlerësimin e njohurive	Testi i dytë. Vlerësohet me 30%

LISTA E LEXIMEVE TË NEVOJSHME PËR KURSIN
(*Literatura*)

Autori dhe viti i botimit të veprës	Titulli	Vendi i botimit
Gjokutaj, Mimoza; Mërkuri, Nexhip. (2002)	<i>Modele te sukseshme mësimdhënieje</i>	Tiranë
Grup autorësh (Pepa, S.; Radovicka, L.; Dizdari, I.; Shashaj, A.; Dardha, Sh.)	<i>Metodika e gjuhës shqipe</i>	Tiranë
Gjokutaj, Mimoza; Shahini, Ladi etj. (2005)	<i>Mësimdhënia me në qëndër nxënësin,</i>	Tiranë
Kazazi, Njazi; Garuci, Nazire; Zhabjaku, Nadir (2005)	<i>Didaktikë e gjuhës shqipe</i>	Tiranë
Tezak, Stjepo (2003)	<i>Teorija i nastava hrvatskog vezika</i>	Zagreb
Musai, Bardhyl (2003)	<i>Metodologji e mësimdhënies</i>	Tiranë
Musai, Bardhyl (2004)	<i>Mësimdhënia dhe të nxënësve ndërveprues</i>	Tiranë
Grup autorësh (2005)	<i>Mësimdhënia dhe të nxënësve ndërveprues, modele për zhvillim të menduarit kritik të nxënësve, klasat 6-12,</i>	Tiranë
Mustafa, A. (2004)	<i>Didaktika e gjuhës shqipe dhe e leximit letrar</i>	Shkup
Dibra, Gëzim; Dizdari, Islam (2004)	<i>Metodologjia e mësimdhënies</i>	Shkodër
Grup autorësh (2008, 2009)	<i>Mësimdhënie dhe të nxënësve ndërveprues</i>	Tiranë
Grup autorësh (1999)	<i>Metoda të mësimdhënies</i>	Tiranë

Grup autorësh: Plani dhe programi mësimor	<i>Plani dhe programi mësimor 1</i>	Prishtinë
.	Leksione, interneti etj	

Prishtinë , më 10 tetor 2018